

**VENDIM**  
**Nr.8, datë 18.12.2019**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË APARTAMENTEVE QË DO T'IU DHUROHEN FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE SI PASOJË E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", të aktit normativ nr.6, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019", dhe të vendimit nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë", dhe në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore në qarkun e Durrësit si dhe të Tiranës, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot më 18.12.2019,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listave nr.1 dhe nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi, për apartamentet që do t'iu dhurohen familjarëve të viktimave, bazuar në aktin normativ nr.6, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019", sipas informacionit të përcjellë me shkresën nr.4, datë 12.12.2019, të drejtuesit qendror të operacionit për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore z. Bledar Çuçi, ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, përkatësisht sipas vendndodhjes së apartamenteve, të marrin masa për përbalimin e shpenzimeve për dhurimin e tyre, përfshirë shpenzimet procedurale, të mobilimit dhe të pajisjeve elektroshtëpiake për këto apartamente nga fondi publik i banesave sociale dhe /ose fondi përkatës i buxhetit të shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOR  
TË EMERGJENCAVE CIVILE  
KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

Lista e përfituesve të apartamenteve/banesave administrative Thumanë - Bashkia Krujë		njësia
	<b>Lista nr.1</b>	
NR.	Familja sipas certifikatave familjare të viktimave	Apartament/Banesë
1	Manjola Cakoni	Apartament nr.20, 209/73+1-25, me sipërfaqe 97,12 m <sup>2</sup> (2+1) me adresë Rr. "Demokracia", Kamzë.
2	Albert Cara	Apartament nr.18, 209/73+1-18, me sipërfaqe 97,12 m <sup>2</sup> (2+1) me adresë Rr. "Demokracia", Kamzë.
3	Lindita Cara	Ap 2+1 nga fondi i banesave sociale -Shkozë
4	Bujar Cuka	Don Bosko Tiranë kompleksi Fior di Bosco, Tiranë, apartament nr.211, kulla 1, shkalla 2, kati I me sipërfaqe 95,5 m <sup>2</sup> .
5	Aleks Çupi	Apartament nr.9, 209/73+1-9 me sipërfaqe 62,54 m <sup>2</sup> në Rr. "Demokracia", Kamzë.
6	Klotilda Greku	Banesë 2+1 nga fondi i banesave sociale, Shkozë
7	Denisa Greku	Banesë 1+1, nga fondi i banesave sociale, Shkozë.
8	Dorjan Greku	Banesë 1+1, nga fondi i banesave sociale, Shkozë.
9	Haxhi Kabili	Banesë 2+1 nga fondi i banesave sociale, Shkozë
10	Roland Lala	Apartament nr.10, 209/73+1-10, me sipërfaqe 84,39 m <sup>2</sup> , me adresë Rr. "Demokracia", Kamzë.
11	Ana Preçi	Apartamenti nr. 209/73+1-19, me sipërfaqe 93,89 m <sup>2</sup> , me adresë Rr. "Demokracia", Kamzë.

12	Fehmi Vata	Banesë 3+1, nga fondi i banesave sociale, Shkozë (së bashku me djalin Servetin).
13	Servet Vata	Banesë 3+1, nga fondi i banesave sociale, Shkozë (së bashku me babain Fehmiun).
14	Diastela Steneci (viktimë, e fejuara e djalit të Albert Carës)	Apartament në Korçë (Bashkia Korçë)
15	Jani Lala	Do të trajtohet nga fondi rindërtimit.

Lista e përfituesve të apartamenteve/banesave Bashkitë Durrës - Krujë		
Lista nr.2		
NR.	Familja sipas certifikatave familjare të viktimave	Apartament
1	Perikli Konomi (Familja Reci)	Apartament nr.27/292/ND+4-8, hyrja 4, apartament nr.8, Durrës
2	Ajet Mecja, (familja Karanxhaj, Mecja)	Apartament nr.4/107,+1-3/3, rruga "Skënderbej", hyrja 1, ap.3/2, me sipërfaqe 51.40 m <sup>2</sup> , Durrës.
3	Marjana Rexhepi (Familja Rexhepi)	Apartament 2/410, +1-16, me sipërfaqe 53.15 m <sup>2</sup> , me adresë rruga "K.Kazanxhiu", hyrja 1 apartament nr.6, Durrës.
4	Fatmir Gjana (familja Gjana)	Apartament nr.4/107, +1-6/4 rruga "Skënderbej", hyrja 1, apartament 6/1, me sipërfaqe 99,30 m <sup>2</sup> , Durrës.
5.	Blerim Lala	Apartament nr.222, kulla 1, me sipërfaqe 97.7 m <sup>2</sup> (sipërfaqe totale 109.7 m <sup>2</sup> ), Rezidenca Alba, rruga "Ndre Mjeda", Tiranë.
6.	Albert Lala (Familja Lala)	Apartament nr.223, kulla 1, sipërfaqe apartamenti 97.7 m <sup>2</sup> (sipërfaqe totale 109.7 m <sup>2</sup> ), Rezidenca Alba, rruga "Ndre Mjeda", Tiranë.
7.	Shkelqim Lala (Familja Lala)	Apartament me adresë Rruga e Durrësit, me sipërfaqe 106 m <sup>2</sup> (sipërfaqe totale 125.4 m <sup>2</sup> , objekti në ndërtim sipas lejes së ndërtimit nr.A-29316/6 datë 2.2.2017), Tiranë.